

VENDIM
Nr. 118/2023

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR FIKS TË ANËTARIT
TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 98, pika 1, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Masa e shpërblimit mujor fiks e anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar është 30 për qind e masës së përcaktuar në pikën F/5 të lidhjes nr. 1 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

II. Vendimi i Kuvendit nr. 82/2015, “Për caktimin e masës së shpërblimit mujor fiks të anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar” shfuqizohet.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 2.11.2023.